



BASHKIMI I SINDIKATAVE TË PAVARURA TË KOSOVËS
THE UNION OF INDEPENDENT TRADE UNIONS OF KOSOVA

Adresa: Rr. "Nëna Terezë" 35, 10 000 PRISHTINË,
Tel/fax: ++381(0)38 229 838, e-mail: bspk@etuc.org

Përfshirja e shoqërisë civile në procesin e hartimit të legjislacionit

Prishtinë 30 qershor 2011 - Zyra e projektit TACSO – në Kosovë në bashkëpunim me Fondacionin Kosovar për Shoqëri Civile me 28 qershor 2011, organizuan punëtorinë me temën “Përfshirja e shoqërisë civile në procesin e hartimit të legjislacionit “ e cila u mbajt në lokalet e Qendrës Kulturore dhe Informativë të BE-së.

Përfaqësues nga BSPK-ja në këtë punëtori ishin Shukrije Rexhepi dhe Dafina Mehaj. Objektivi i kësaj punëtorie ishte publikimi i studimit “ Po rritemi së bashku” të autorëve Taulant Hoxha (KCSE), Besim Kajtazi (Qeveria e Kosovës) dhe Shqipe Pantina, Studimi "Po rritemi së Bashku" ishte bërë gjatë periudhës prill / qershor të vitit 2011. Huluntimi ishte i bazuar në intervistat e përfaqësuesve të institucioneve përkatëse dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile.

Qëllimi i këtij huluntimi ishte rëndësia dhe ofrimi i një pasqyre mbi përfshirjen e shoqërisë civile në bërjen e ligjeve, rregulloreve dhe dokumenteve tjera publike në Kosovë, përkatësisht në ciklin legjislativ të Kosovës, se sa i jepet hapësirë organizatave të shoqërive civile që të përfshihet në këtë cikël.

Ky raport bënë thirrje për fuqizimin e zërit të qytetarëve, lidhur me kontributin e tyre në bërjen e ligjeve sa më të mira dhe të implementueshme. E gjithë kjo, me qëllim që Kosova të bëhet një vend me standarde Evropiane dhe me një demokraci të zhvilluar. Mos përfshirja sa duhet e qytetarëve në politikë-bërje dhe në procesin legjislativ gjithëherë është brengosëse dhe me siguri që do të na ofrojnë politika dhe legjislacione më pak të kënaqshme.

**Zyra për Informim, BSPK
Fatma Rastelica**